



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr.94
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303
Prishtinë, më 30 prill 2024, në orën 11:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Meta, Bekim Haxhiu, Shemsedin Dreshaj, Samra Ilijazi, anëtarë.

Mungoi: Floretë Zejnullahu, anëtare.

Pjesëmarrës të ftuar: Albert Lila, drejtor i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, Skënder Krasniqi, specialist dhe Qefsere Gashi, specialiste e mjekësisë së punës nga Instituti i Mjekësisë së Punës në Obiliq.

Stafi mbështetës: Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

Pjesëmarrës të tjerë: Merita Selmani, juriste nga Instituti i Mjekësisë së Punës në Obiliq, Violeta Emini, KSHMS.

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 28.3.2024 dhe 2.4.2024;
3. Mjekësia e punës, të arriturat dhe sfidat;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 28.3.2024 dhe 2.4.2024

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura të datave 28.3.2024, dhe 2.4.2024, u miratuan pa vërejtje.

Fatmire Kollçaku, tha se tema e diskutimit, për të cilën i kemi ftuar palët, janë mjekësia e punës, të arriturat dhe sfidat, që është edhe shënimi zyrtar i ditës së punës. Në këtë mbledhje janë të ftuar përfaqësues të institucioneve nga Instituti i Mjekësisë së Punës në Obiliq dhe Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë. Znj. Kollçaku, tha se si komision, që disa vite e kemi promovuar punën e mjekësisë së punës, duke u angazhuar për t'iu gjetur zgjidhje për statusin e tyre, që është ende i padefinuar. Pastaj ua kaloi fjalën përfaqësuesve të këtyre institucioneve, për të informuar deputetët me problemet tyre rreth funksionimit të mjekësisë së punës.

Skënder Krasniqi, specialist i mjekësisë së punës nga Instituti në Obiliq, e paraqiti ekspozën e funksionimit të Institutit të Mjekësisë së Punës në Obiliq ndër vite dhe kërkesën për zgjidhur statusin e tyre të padefinuar, si në vijim: Mjekësia e punës në Obiliq funksionon që nga vitet e gjashtëdhjeta. Në fillim, si një ambulancë e kombinatit xehetaro-metalurgjik e pastaj në të shtatëdhjetat si Dispanser i Mjekësisë së Punës. Në vitet e nëntëdhjeta emërohet ent i mjekësisë së Punës, ndërsa që nga viti 1999 emërohet si Instituti i Mjekësisë së Punës (IMP), në kuadër të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Me procesin e ristrukturimit të KEK-ut, më 1.4.2006 është regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si Instituti i Mjekësisë së Punës, ndahet dhe veprimtarinë e vet e vazhdon të njëjtën, por me një status të ri, si shoqëri aksionare, me adresë në Obiliq, ku bartës të veprimtarisë janë punëtorët e Institutit, ku edhe sot vepron me këtë organizim, ndërsa objektet dhe të gjitha mjetet themelore që posedonim në atë kohë, na u janë dhënë me qira nga KEK-u. IMP-ja është institucion me rëndësi i Shëndetësisë së Kosovës, ku përveç veprimtarisë sekondare shëndetësore, ushtrijmë edhe veprimtari themelore shëndetësore, specifike e veçantë është Shërbimi për Mbrojtje nga Rrezatimi Jonizues dhe Jo-jonizues dhe Higjienën e punës, i cili është i vetmi departament në nivel vendi, që ofron shërbime për mbrojtje nga rrezatimi që nga viti 1978, në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ky shërbim bën matjen e rrezatimit në ajër, ujë, tokë, dhe ushqim, kontrollin e cilësisë dhe sigurisë nga aparatet e rëntgenit (burimet radioaktive) në mjekësi dhe industri, dozimetrinë personale etj. Preokupim i vazhdueshëm i yni ka qenë dhe mbetet bashkëpunimi dhe përfshirja e IMP-së në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Jemi të bindur që IMP i plotëson të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Shëndetësi dhe Udhëzimin Administrativ për organizimin dhe veprimtarinë e mjekësisë së punës, për të qenë Institut i Mjekësisë së Punës, në kuadër të sistemit shëndetësor publik në Kosovë. Me keqardhje themi, se e ardhmja e IMP-së, pa mbështetje nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk do të jetë e sigurt dhe si rezultat do të shkatërrohej një institucion profesional me përvojë mbi 50- vjeçare dhe me 50 punonjës. Në këtë kuadër, ju informoj se KEK-u, në bisedimet paraprake, është pajtuar që të bëjë bartjen e asetëve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Shëndetësisë. **Në vijim, paraqesim një njoftim të shkurtër për veprimtarinë e Institutit të Mjekësisë së Punës:** vlerësimi paraprak i gjendjes shëndetësore të punëtorëve; vizitat kontrolluese-periodike të punëtorëve që punojnë në vendet me rrezikshmëri për shëndetin, të përcaktuara me aktet e përgjithshme mbi mbrojtjen dhe siguri në punë; vlerësimin e gjendjes shëndetësore të punëtorëve të lënduar në punë dhe atyre me sëmundje profesionale për dërgimin në qendra për rehabilitim dhe riaftësim; vizitat mjekësore të punëtorëve që udhëtojnë jashtë vendit

(sipas nevojës dhe kërkesës); studimi i shkaqeve të sëmundjeve dhe pushimeve mjekësore (nga profesionistët shëndetësorë). Vlerësimi i gjendjes së mbrojtjes dhe sigurisë në punë nga lëmi i mbrojtjes nga rrezatimi radioaktiv (matja e radioaktivitetit në ushqim, ajër, tokë, ujëra sipërfaqësore dhe puse, si dhe në të gjitha vendet e punës); matja e rrezatimit jonizues dhe jonizues (këto shërbime i kryen Departamenti i Mbrojtjes nga Rrezatimi, me ekspert adekuat); kryen vizitat e patronazhit në shtëpi të punëtorëve për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të sëmurave me sëmundje kronike dhe atyre që gjenden në pushim mjekësor; kryen trajnimin praktik dhe teorik të punëtorëve nga lëmi i ndihmës së parë dhe edukimit shëndetësor, në bazë të akteve adekuate ligjore; organizon dhe kryen vizita mjekësore emergjente në IMP dhe në vendet e punës, në rast të aksidenteve në vendin e punës, si dhe bën transportin me autoambulancën e ndihmës së shpejtë me përcjellje profesionale të të sëmurave dhe të aksidentuarve në klinikë, por sipas nevojës edhe jashtë vendit; bashkëpunon me Departamentin për Mbrojtje dhe Siguri në Punë; puna shkencore hulumtuese dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë, Fakultetin e Mjekësisë, institucionet dhe dispanseritë e Mjekësisë së Punës në Kosovë dhe jashtë. Kryen të gjitha super-ekspertizat për matjen e invaliditetit në punë pas lëndimeve. Qëllimi i IMP-së është ofrimi i shërbimeve profesionale kualitative nga lëmi i mjekësisë së punës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, duke kërkuar që Instituti i Mjekësisë së Punës, të përfshihet në kuadër të shëndetësisë publike, siç është e paraparë edhe me Ligjin për Shëndetësi, nr. 04/L-125.

Albert Lila, drejtor i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, foli për rolin e institucionit që ai e drejton, duke thënë se statusi i veprimtarisë së mjekësisë së punës, ende është i padefinuar në aspektin ligjor. “Në planin afatgjatë, ne do ta bëjmë specializimin sa më atraktiv për mjekët e rinj. Sot ka degraduar situata deri atje, ku vizitat sistematike kryhen në institucione që janë të licencuara, por që janë private. Kërkesat dhe normat e kualitetit të shërbimit shkojnë deri atje ku bëhen analiza dhe një vizitë familjare dhe i thuhet që je i aftë për të vazhduar punën. Sa për informatën e tuaj, nga 400 mijë të punësuar që janë në Kosovë, që janë të regjistruar në ATK në vitin 2023, 6850 punëtorë kanë kryer vizitën sistematike që i bie më pak se 1.5%. Çdo i punësuar në Kosovë, si në sektorin publik dhe privat, duhet të kryejë një vizitë sistematike një herë në tre vite. Përrjashtuar këtu, kategori të veçanta, si zjarrfikësit që duhet kryer një herë në vit. Mjekësia e punës në Kosovë duhet që të organizohet në nivel vendi, që çdo rajon të ketë një dispanser. Po të duam ta zbatojmë ligjin dhe normat ligjore që kanë vendet e rajonit dhe vendet që janë integruar në BE”.

Qefsere Gashi, specialiste e mjekësisë së punës nga Instituti në Obiliq, tha se prej vitit 2006 jemi jashtë Korporatës Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.), që kemi qenë në kuadër të ndërmarrjes së KEK-ut, punën tonë profesionale si institut e ushtrijmë duke lidhur marrëveshje kontraktuale me industrinë e rënda, siç është kompania “Sharrcem” dhe KEK-u.

Haxhi Avdyli, pyeti: Sa është numri mjekëve që punojnë në Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq?

Qefsere Gashi, specialiste e mjekësisë së punës nga Instituti në Obiliq, tha se numri i mjekëve është 29 dhe 12 janë staf. Dhe prej kur na kanë larguar prej KEK-ut, punëtori nuk ka dinjitet, p.sh. punëtori që 14 vjet që punon në KEK e ka humbur shëndetin dhe del pa asnjë pikë dinjiteti. “Ai është i përlulur para familjes, para shoqërisë dhe vetvetes. KEK-u me industri të rëndë, që prin me numrin e lëndimeve, statistikat i dimë. Ne nuk e kemi mjekun afër, nuk e kemi ambulanten

brendapërbrenda. Kur është institucioni brenda fabrikës, atëherë edhe orët e humbura janë më të vogla. Nuk e di pse KEK-u nuk e sheh të arsyeshme të na kenë neve për vizitë sistematike. Punëtorët në industrinë e rëndë duhet të organizojnë një herë në vit vizita në bazë të rrezikshmërisë. Si mjeke e punës, një punëtor në qoftë se është punësuar më pak se një vjet, me ia lyp certifikatën mjekësore, më thonë kush të ka shti ty në punë, vjen me epilepsi çka të bësh tash. Tash kush janë këta trima që i shtinë punëtorët pa asnjë dokument mjekësor të punojnë”.

Armend Zemaj, tha se mjekësia e punës duhet të fuqizohet dhe të avancohet përmes legjislacionit, prandaj rekomandojmë Qeverinë të ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e problemeve, sidomos të mjekësisë së punës në Obiliq. Lidhur me këtë, pjesën e partneritetit publiko-privat, të shohim duke marrë parasysh që ka të bëjë me shëndetin publik ose shëndetin e punëtorëve, sepse ne dëgjojmë raste ose bëhemi adresa e parë ose e dytë e një kërkesë për ndonjë ndihmesë, sidomos kur kemi të bëjmë me punëtorët që kanë ose marrin pasoja të sëmundjeve që janë edhe specifike që quhen profesionale, dhe deri te sëmundjet më të rënda që janë si pasoj nga vendi i punës, prandaj duhet të merremi seriozisht me çështjen e mjekësisë së punës, pasi që ky proces është stërzgatur për të gjetur zgjidhje, lidhur me statusin tuaj, dhe kohët e fundit, është përshkallëzuar edhe më keq raporti me KEK-un, pas privatizimit të pjesës së rrjetit distribucionit rrjetit shpërndarës. Andaj, ne si komision duhet t’u përkrahim në këtë drejtim për të gjetur zgjidhje, sa i përket statusit tuaj dhe të insistojmë te Ministria Shëndetësisë, që t’iu fusin në Projektligjin e ri për shëndetësi, sepse është zgjidhje e vetme, të jeni pjesë e ligjit të ri.

Mirsad Shkreta, tha se janë të vetëdijshëm edhe si deputetë, edhe si qytetarë për rëndësinë që ka pasur dhe ka mjekësia e punës. Sa i përket statusit tuaj, kjo çështje ende nuk ka marrë epilog, duke gjetur zgjidhje ligjore. Ai tha se shifrat e sëmundjeve në industrinë e rëndë janë të shumta dhe kërkesat e juaja janë të drejta, për shkak të trajtimit që duhet t’u bëhet këtyre sëmundjeve që shkaktohen nga vendi i punës. Përveç që e dimë rëndësinë që ka mjekësia e punës, duhet t’i japim një dimension tjetër edhe akomodimit në ligj, duke e përfshirë Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq, si dhe Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë.

Haxhi Avdyli, tha se avancimi i mbrojtjes shëndetësore në vendin e punës është edhe avancim i mirëqenies së të drejtave të punëtorëve. Sa i përket çështjes së mjekësisë së punës, duhet pasur një koncept të ri për t’u gjetur zgjidhje, pasi që mjekësia e punës ka ndërlidhje më shumë me mjekësinë familjare se me mjekësinë sportive, pasi që mjeku familjar është një mjek në kuptimin e konceptit të përgjithshëm shëndetësor. “Unë desha të jap një mendim rreth organizimit të mjekësisë së punës. Mjekësia e punës ka lidhje më shumë me mjekësinë familjare, sesa me mjekësinë sportive. Mund të ketë edhe me mjekësinë sportive, por mjeku familjar është një mjek në kuptimin e konceptit të përgjithshëm shëndetësor. Por, në të njëjtën kohë, mjeku i punës është një mjek që duhet ta njohë në tërësi mjekësinë, veçanërisht në aspektin e ndikimit të dëmtimeve të jashtme, që vijnë nga vendi punës. Sidoqoftë, në këtë drejtim, mendoj që këto dy koncepte mund të na ndihmojnë. Por, unë mendoj që duhet të ketë një bashkëpunim dhe një koordinim të këtyre koncepteve politike, që kanë qëllimin e njëjtë”.

Shemsedin Dreshaj, tha se shumica e gjërave vetëm u thanë. Ajo çka është faktike, është se mjekësia e punës, është anashkaluar nga gjithë sistemi shëndetësor, por ajo tani çka duhet të mbetet në fokus, është se ju duhet ta keni gamën e shërbimeve mjekësore, që do të ofrojnë, siç janë

kontrollet sistematike dhe aftësitë e kryerjes së punës, që mund ta bëjnë punëtorët për këto çështje. Të dyja institucionet duhet të sjellin gjithë dokumentacionin e aktiviteteve dhe shërbimeve që e ofroni, për ta argumentuar punën e juaj, në mënyrë që t'ju mundësohet edhe dhënia e certifikatave që duhet të kryhet nga Instituti i Mjekësisë së Punës. Ajo çka duhet ta kemi fokus, është që në Projektligjin e ri për shëndetësi, që pritet të vijë këtë vit dhe në Udhëzimin Administrativ për organizimin dhe veprimtarinë e mjekësisë së punës, që i kanë larguar vizitat sistematike të punëtorëve, të rregullohen me mundësitë për përfshirjen sa më të saktë në Ligjin për shëndetësi.

Bekim Haxhiu, tha se jona si Komision funksional parlamentar, është për t'iu takuar dhe për t'i adresuar problemet e juaja që keni, lidhur me statusin e padefinuar. Në këtë drejtim, e keni mbështetjen tonë. Por për ta zgjidhur këtë problem, duhet që Ministra e Shëndetësisë, me anë të Ligjit të ri për shëndetësi, por që fatkeqësisht deri më tani nuk e ka sjellë MSH-ja dhe Qeveria. Tash, kësaj Qeverie dhe legjislature, nuk i ka mbetur shumë kohë, kemi veç edhe 8 muaj maksimum, kohë efektive për ta përmbyllur këtë legjislaturë. Ai tha se kur kemi 1.5 për qind vizita sistematike, s'mundemi të flasim për dështim të sistemit. Mund të flasim për vështirësi e pengesa e për të ardhmen si ta përmirësojmë. "E rëndësishme për ne ka qenë që të takohemi për të parë saktë gjendjen shëndetësore të punëtorëve në Kosovë. Në prag të kësaj feste, për të parë të arriturat dhe sfidat".

Skënder Krasniqi, nga Instituti i Mjekësisë së Punës, tha se neve na intereson që të gjendet një zgjidhje ligjore, sepse gjendja në mjekësinë e punës është mjerueshme. "Ne jemi në gjendje alarmante. Familjarët e punëtorëve po vuajnë. Fjalori im nuk është politik, është tamam i një qytetari të thjeshtë. Ne nuk kemi ardhur as të shesim mend, as t'i lavdërohem dikujt, por të tregojmë realitetin. Është një gjendje alarmante, ejani edhe shihni qysh punojnë në mjekësi të punës", tha ai.

Mirsad Shkreta, tha se i kuptojmë shqetësimet e juaja, sepse problemet deri më tash janë zgjidhur ad-hok. Koncepti mjekësisë së punës duhet të rregullohet me Ligjin për shëndetësi, ndoshta duhet të zgjerohet pak gama e shërbimeve mjekësore, në kuptimin e institucionit që do të bëhet në ligj, andaj duhet gjetur akomodim me anë të ligjit, pasi që kjo temë nuk ka marrë adresim adekuat.

Albert Lila, drejtor i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, sqaroi se në Ligjin për shëndetësi, që është në fuqi, te neni 29, Mjekësia e punës: 1. Mjekësia e punës si shërbim i kujdesit shëndetësor për punëtorë, ofrohet në kuadër të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor. 2. Themelimi, organizimi dhe veprimtaria e shërbimit profesional të mjekësisë së punës përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria. Por, akti nënligjor, që do ta rregullonte problemin e statusit të mjekësisë së punës, ende nuk është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Lidhur me këtë çështje, kërkoi nga Komisioni që të llojë për t'iu gjetur zgjidhje me anë të miratimit të akt nënligjor, në mënyrë që mjekësia e punës të rregullohet me status të veçantë dhe funksionimi i saj të bëhet duke lejuar ofrimin e disa shërbimeve mjekësore, siç janë kontrollet sistematike me vizitat kontrolluese-periodike të punëtorëve që punojnë së pari në sektorin publik dhe në atë privat dhe duhet të na lejohet lëshimi i certifikatës mjekësore, duke i pasur në monitorim të vazhdueshëm shëndetin e punëtorëve, me anë të kontrolleve sistematike, sidomos të ndërmarrjeve lokale publike, që punojnë në kushtet më të vështira, por edhe të atyre private.

Fatmire Kollçaku, pasi bëri një rezime të punës dhe problematikës së mjekësisë së punës, pasi që edhe përfaqësuesit e Institutit të Mjekësisë së Punës nga Komuna e Obiliqit dhe Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës nga Komuna e Gjakovës, i paraqitën shqetësimet e tyre, lidhur me mbarëvajtjen e punës në segmente të caktuara, përfshirë vizitat e detyrueshme të punëtorëve dhe lëshimit të certifikatave shëndetësore për ta. Ajo tha se mjekësia e punës do të ketë vazhdimisht përkrahjen e Komisionit, për realizimin e qëllimeve të tyre, sepse çdoherë, në fokus duhet ta kemi shëndetin në punë. Në vijim, tha se problemi kryesor kyç është statusi i juaj ligjor dhe këtë vit është gati për të ardhur Projektligji i ri për shëndetësi, dhe Komisioni ka vullnet që nëpërmes këtij ligji, ta definojë statusin e juaj. Në fund, kërkoi që propozimet dhe kërkesat e tyre t'i adresojnë me shkrim.

5. Të ndryshme

Për pikën të ndryshme nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisionit
